

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton shkojnë një hap më tej? Edhe bagazhet e tyre janë... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/kim-kardashian-dhe-lewis-hamilton-shkojne-nje-hap-me-tej-edhe-bagazhet-e-tyre-jane/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 15:51:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fc34c7871a5a86936844a0719fa35a84e0c6f67e8aab70c1bf3e0808e0bedb8c
TEKSTI	896c3420002d8a5eae3f662777dfeec5da5c673733b20bc0b7825545b454823f
PAMJA	0187a71e3b0c3cdc53a2971697dd9c3d46c0ae2dde28c45bbb99c853c0652042

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be62e5666c8a860c0b045d9791414b72edbf8de5bacfc8abdf58dd15c3c694b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse për

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton shkojnë një hap më tej? Edhe bagazhet e tyre janë...



Redaksia K

23 Shtator 2026



Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton duket se po e çojnë gjithnjë e më tej stilin e tyre si çift. Këtë herë, detaji që tërhoqi vëmendjen nuk ishte një dalje romantike apo një paraqitje në tapetin e kuq, por diçka shumë më diskrete: bagazhet e tyre të personalizuar.

Kim publikoi të mërkurën një seri fotografish në Instagram, ku mes momenteve nga udhëtimet dhe jetës së saj luksoze shfaqeshin edhe dy çanta udhëtimi "Goyard", një rozë për të dhe një të zezë për Lewis Hamilton.

Detaji që i bëri edhe më të veçanta ishte personalizimi. Çanta rozë e **Kim** mban emrin e saj, ndërsa ajo e Hamilton është e zezë dhe mban numrin 44, numri që piloti britanik përdor në Formula 1.

Dy çantat duket se janë fotografuar brenda avionit privat të themelueses së SKIMS, duke i dhënë edhe më shumë luks pamjes. Dhe sigurisht, fakti që të dy kanë zgjedhur versione që përputhen nuk kaloi pa u vënë re nga fansat.

Por bagazhet janë vetëm një nga detajet që kanë treguar se marrëdhënia e tyre është bërë gjithnjë e më publike. Çifti ka udhëtuar së bashku në disa destinacione dhe së fundmi kaloi kohë në Londër, ku **Kim** ishte për hapjen e dyqanit të parë ndërkombëtar të SKIMS. Gjatë qëndrimit atje, ata u panë edhe duke lëvizur me biçikleta Lime nëpër qytet.

Pas Londrës, Kim dhe Hamilton u shfaqën së bashku edhe në Los Angeles, në hapjen e Lucas Museum of Narrative Art më 19 shtator. Edhe pse nuk pozuan së bashku në tapetin e kuq, brenda eventit u fotografuan pranë njëri-tjetrit dhe ndanë momente romantike.


Madje, një video nga mbrëmja u bë virale, pasi Kim dhe Lewis u panë duke u puthur. Pas puthjes, Kim i fshihte me gisht gjurmën e buzëkuqit që i kishte mbetur Hamiltonit në buzë.



Edhe Hamilton ka ndarë së fundmi një seri fotografish nga koha e kaluar me Kim, duke përfshirë momentet e tyre në Londër, një mbrëmje private në ambient të hapur dhe një dalje romantike. Për postimin e tij ai shkroi: “Pak nga kjo, pak nga ajo.”

Ndërkohë, marrëdhënia e tyre tashmë është bërë publike edhe në rrjetet sociale. **Kim dhe Hamilton** kishin ngjallur thashetheme për një lidhje që në fillim të vitit, ndërsa më pas nisën të shfaqeshin gjithnjë e më hapur së bashku.





Dhe nëse daljet e tyre, udhëtimet luksoze dhe momentet romantike nuk mjaftonin, tani kanë edhe një tjetër detaj që i bashkon: çanta “Goyard” të personalizuar, rozë për Kim dhe të zezë me numrin 44 për Lewis.

Duket se për Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton, edhe një udhëtim i zakonshëm duhet të ketë dozën e vet të luksit dhe stilit.

LAJME TË NGJASHME



Kim Kardashian mahnit në galanë e muzeut të George Lucas!

2.5 MIN



Kim Kardashian nuk ndalet në Londër! Ndryshon tre herë veshjen?

2.5 MIN



Kim Kardashian dhe Lewis Hamilton befasojnë, eksplorojnë qytetin me...

1 MIN



Lewis Hamilton reagon pas bujës me Macklemore dhe Ed Sheeran!

1.5 MIN



Shtrohet në spital Kim Kardashian, çfarë i ka ndodhur yllit të njohur televiziv?

1 MIN

MË TË LEXUARAT



“E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë...”/Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur...



Ish-banorja e “BBV”, Amber surprizon me transformimin e ri/FOTO!



Parkim me pagesë nga 5 tetori në Durrës, ja sa do të paguajnë qytetarët dhe çfarë përfitojnë rezidentët



Njihuni me ishullin ku derrat notojnë me turistët!



De Rossi ende nuk i jep minuta
në Serie A mbrojtësit të
Kombëtares shqiptare Mario
Mitaj!



Premier League/ Manchester
City është i pandalshëm, tre pikë
edhe për Liverpoolin!

